

RELACION TEKNIK

Objekti : *Rikonstruktion i shkolles 9-vjecare*
“Skender Libohova” dhe shtese anesore
Lushnje

- **Hyrje**

Shkolla 9-vjecare “Skender Libohova” ndodhet ne qytetin e Lushnjes ne lagjen “Skender Libohova”. Kjo shkolle ndodhet ne krahe te gjimnazit “18 tetori” prane rruges “Msito Mame”. Shkolla eshte nje godine 3 kateshe me muraturë mbajtese tulle 45 cm, mbuluar me tarace, e ndertuar afersisht ne vitin 1948.

Ne elementet qe perbejne strukturen mbajtese te godines si muret ,soletat,traret nuk ka shenja te dukshme te amortizimit te tyre por jane ne gjendje te mire konstruktive ndersa rifinitura e brendshme ka demtime te pjesshme.

Elementet e tjere te godines si:shkarkimet e ujerave nga tarraca dhe hidroizolimi i saj,dyert e dritaret e brendeshme, shtresat e dysHEMEVE, suvatimet, instalimet elektrike,nyjet hidrosanitare jane te degraduara si pasoj e kushteve atmosferike dhe kohes se gjate kur eshte ndertuar kjo shkolle.

Ne imazhet fotografike eshte pasqyruar gjendja e tanishme e shkolles.





- **Pershkrimi i projektit**

Rikonstruksioni i shkollës 9-vjecare “Skender Libohova” parashikon rinovimin dhe rivitalizimin e plote të objektit. Gjithashtu parashikohet edhe zgjerimi me një shtesë ballore në hyrje për shtimin e ambienteve pasi ndertesa ekzistuese ka mungesa.

Rikonstruksioni parashikon nderhyrje si :

- **Punime tarrace(cati + Hidro dhe Termo izolim)**

Termoizolimi mungon totalisht në të gjithë hapësirën e terraces duke e bërë të pamundur zhvillimin e mesimit në kushte normale sepse sipasoj e kushteve atmosferike i bëjnë ambientet nën tarrace të tejnxehura dhe të ftohta duke krijuar efekte të sërë të demshme për trupin. Do të bëhet mbulimi me cati I objektit ekzistues në të gjithë tarracën, ndërsa për shtesën do të përdoret polisteroli me $t=10$ cm që do të vendoset mbi soletë. Pas kësaj shtrese përdoret lluster cimento 2 cm dhe sipër saj hidroizolimi me 2 duar katrama 1 cm. Hidroizolimi nuk është në gjendje të mirë, ai është ndërtuar jo në kushte të mira teknike dhe është amortizuar dhe krijon futjen e ujërave të shiut në soletë duke krijuar lagështi dhe myk në klasat ku zhvillohet mesimi. Në të gjithë perimetrin e shkollës do të vendoset një pikore llamarine me trashësi 1 mm që do të mundësojë rrjedhjen e ujërave të shiut të cilat do të disipilohen me ulluqe vertikale, duke siguruar pjerresinë e terraces së shtesës me 2% në dy drejtime. Forma e catise mbi soletën ekzistuese ka siguruar një mbulim të mirë të grumbullimit të ujërave, dhe drejtimin e tyre në ulluqet horizontale dhe vertikale. Tubat e përdorur janë plastik me $\varnothing 100$ mm dhe $\varnothing 200$ mm

- **Dyer dhe Dritare**

Dyert e brendshme të klasave dhe të ambienteve tjera janë prej druri. Ato janë të deformuara të pa lyera, pa brava dhe të thyera në disa raste ato janë jashtë funksionit dhe mbyllën me veshitësi. Do të bëhet ndrimi total i tyre për të gjitha ambientet në standartet e kerkuara sic paraqiten në projekt. Dritaret janë duralumini, teci i tarracave funksionale porskema e përdorimit të tyre në kushte konform regullave teknike për dritare të institucioneve shkollore. Xhamat e tyre janë teke dhe krijojnë një termoizolim jo të mirë për ambientin dhe në disa raste të thyera. Zevendesimi i dritareve të objektit me D/Aper të arritur në kushte të mira për termoizolim. Dimensionet dhe stili që do të përdoren është paraqitur në projektin teknik të rikonstruksionit të shkollës. Për sigurinë e ambienteve të shkollës do të vendosen kangjella në të gjitha dritaret e katit për dhe sipas konfigurimit të paraqitur në projektin teknik. Dyert e ambienteve të klasave do të jete prej druri dhe do të kenë dritaren e vëzhgimit me permasa 15x85 cm sipërfaqe xhami fikse.

- **Dyshemeja dhe shkallet**

Shkolla ne hapsiren e brendeshme te saje eshte e shtruar me pllaka granili katrore 25x25dhe jane ne gjendje te mire. Duhet vleresuar edhe amortiziminsi material ndertimi teketyrepllakave me pllakateraja.Tevleresohetngazbatuesi i projektit nese pllakat ekzistuese duhet te hiqen ne menyre qe mos te humbasim kuoten e lartesis se katit apo shtimi i ri do te behet mbi ato ekzistueset,ne projekt eshte parashikuar heqja e tyre.Zevendesimi i tyre do te behet me pllaka porcelani gress 50x50cm te nje cilesie te mire dhe shtrimi do te behet i drejte sipas ambienteve. Fugat do te behen 4mm, me kol ne ngjyre qe do te pershtatet me ngjyren e pllakes.Ne te gjithe perimetrin e klasave dhe hapësirave te tjera do te behet konturimi me plintusa qe do te jene me ngjyren e pllakes qe do te shtrohet ne dysheme ne lartesine 10cm.

Shkallet jane te shtruara me pllaka mermeri ne gjendje te mire, por konstatuam nga rilevimi ne objekt qendertimi I tyre nuk eshte bere conform rregullave teknike te ndertimit te nje shkalle, gjeressite dhe lartessite e bazamakeve jane te ndrysheshme, krijojne lodhje te perdoruesve.

Ngavlèresimi I kesaj situatë bazamaket e shkalleve duhen zevendesuar dhe ndertuar sipas rregullave konstruktive.



-Suvatimet e brendeshme dhe te jashteme te mureve

Ne ambjentet e jashtme dhe te brendshme ne klasa, korridore, etj. suvaja eshte demtuar, per shkak te demtimeve nga kushtet atmosferike dhe demtimi nga nxenesit e shkolles. Do te behet zevendesimi ne ato pjese ku eshte demtuar suvaja duke krijuar nje uniformitet me pjeset e tjera. Do te behet dhe suvatimi i spatullave te dritareve dhe dyerve jo me pak se 3 cm.



- Lyerja e brendeshme dhe te jashteme te mureve

Ne ambjentet e jashtme dhe te brendshme ne klasa, korridore, palester etj. lyerja eshte e demtuar, per shkak te demtimeve nga kushtet atmosferike dhe demtimi nga nxenesit e shkolles. Ajo eshte e lyer me gelqerete bardhe ne brendesidhe me ngjyre ne ambjentin e jashtem. Do te behet lyerja me boje hidromat plastike poroz me dy duar qe te jete sa me funksionale dhe vizuale per te gjitha. Ngjyrat do te percaktohen si ne projektin ekzistues duke mos u larguar identitetit te shkolles por me qellimin rivitalizimin e saj. Fasada e shkolles do te vishet me system kapot dhe do lyhet me grafiato sipas ngjyrave te percaktuara ne projekt.



- **Termoizolimi (veshje me kapote)**

Termoizolimi mungon totalisht ne te gjithë hapësirën rrethuese të shkollës duke e bërë të pamundur zhvillimin e mesimit në kushte normale sepse si pasojë e kushteve atmosferike i bëjnë ambientet të tejnxejura dhe të ftohta duke krijuar efekte të demshme për trupin. Do të bëhet termoizolimi në të gjithë hapësirën e mureve të jashtme të shkollës dhe si material shumë i mirë për këtë gjë do të përdoret polisteroli me $t=5$ cm që do të vendoset paralel me murin e jashtëm dhe mberthimi do të bëhet me vida dhe me pas do të vendoset rrjeta e telit për të minimizuar lagështinë. Pas kësaj shtrese do të shtrohet me 2.5 cm suva. Kjo shtresa do të përdoren në të gjitha pjesët e shkollës, duke respektuar detajet teknike të dritareve të paraqitura në projektin sipas rregullave teknike. Të kihen vëmendje shpimi i kapjes së kangjelles së dritareve për të arritur termoizolim të mirë të shpimeve.

- **Instalimet elektrike**

Rrjeti elektrik i ndërtuar prej shumë vitesh është amortizuar totalisht, si rezultat në klasa, koridore, ndricimi është i pamjaftueshëm për zhvillimin e kushteve mësimore. Në disa hapësira si tualet apo në ambiente të ndryshme të shkollës instalimet mungojnë dhe janë djegur sipasoj e berjes mas ose luhatjes së tensionit të cilat pastaj janë rregulluar, por në mënyrë të perkoheshme. Prizat, celesat janë të demtuara dhe në disa raste mungojnë dhe nuk funksionojnë. Do të bëhet rikonstruksioni total i të gjitha hapësirave të sistemit elektrik sa më funksional dhe bashkëkohor. Do të bëhet shtrimi i linjave të reja, zëvendësimi i prizave, celsave, portollambave, kuadreve, etj. Në ambientet e kabinetit të informatikës reflektohen pozicioni i saktë i instalimeve sipas projektit elektrik.

- **Nyjet hidrosanitare**

Nyjet hidrosanitare janë ambiente të demtuara dhe jashtë funksionit në shkollë duke krijuar një situatë të rënduar higjieno – sanitare për shkollën. Ato janë të rikonstruara pjesërisht dhe

jashte sherbimit. Rikonstrukcioni parashikon rikonceprimin e te gjitha hapsires se nyjeve-higjenosanitare nga 3bokse per vajzadhe 3bokse per djem ne dykatet e shkolles.Ketonyeje do te trajtohen me te gjitha elementet si :shtrimi me pllake i dyshemese,veshja e mureve me pllake ,pajisjet hidrosanitare te reja si wc dhe lavaman, dyert dhe dritaret prej alumin per efekt te kushteve sa me te mira higjeno-sanitare. Pervec tyre do te ndertohen dhe tualet per mesuesit meshkuj dhe femra sepse ato mungojne dhe nuk eshte etike qe te perdorin te nxenesve.Ato do te ndertohen ne katin e dyte (+6.20).Ne ambinetin e nyjeve higjenosanitare eshte projektuar edhe nje nyje per PAK ne baze te gjitha kushteve teknike te projektimit .



- Projektimi per PAK (Persona me Aftesi te Kufizuar)

Ne ambientet e shkolles eshte projektuar sipas rregullave te arkitekture pa barriera, ne kete drejtim eshte vendosur ne hyrje te shkolles nje rampe(8%) per personat me aftesi te kufizuar si dhe nje ashensore per te mundesuar aksesim e PAK edhe ne katin e siperm te godines se shkolles.Gjithashtu edhe ne ambientet sanitare eshte projektuar nje nyje higjenosanitare sipas kushteve teknike, te paraqitur ne projektzbatimin e shkolles.

- Punime per sistemimin e jashtem

Ne perimetrin e shkolles do te realizohen disa riparime ne shtresen e jashtme te oborrit. Ne gjendjen ekzistuese jane bere disa sistemim nga mesuesit si dhe familjaret e nxenesve per te permiresuar disa ambientin e jashtme te shkolle. Ne afersi te Hyrjes jane te vendosura disa stola, kosha per letrat si dhe jane bere mbjellje te disa pemeve per te krijuar nje mikroklimen per nxenesit dhe mesuesit. Ne projekt eshte parashikuar nje sistemim i shtreses se siperfaqes qe eshte e shtruar te pasistemuar.



Hartoi:

Drejtor: Mimoza Haxhiu

Pergjegjes: Maksim Cuko

Ark.: Alban Manoku

Ark.: Enis Manoku

Ing.: Ariola Dylia

Ing.: Gani Myzeqari

Ing.: Ersi Veliu

Ing.: Arben Muca